

VENDIM
Nr. 218, datë 27.10.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SHPK PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 136/5 prot., datë 21.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020.

- Shoqëria ka vënë në dijeni ERE-n për transferimin e kuotave ndërmjet ortakëve ekzistues të saj.

- Në zbatim të pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE, në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionarit kryesor.

- Shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

- Në mbledhjen e Bordit u konstatua nevoja për të sqaruar rrethanat dhe dokumentacionin që lidhet me barrësimin e kuotave tek të tretët, për të cilat shoqëria ka kërkuar autorizimin e ERE-s për transferimin brenda shoqërisë, ndaj për saktësimin e këtij dokumentacioni dhe zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore për këtë qëllim, në zbatim të nenit 67, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vlerësohet të shtyhet me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimarrja e Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.

- Gjatë kësaj kohe shoqëria duhet të depozitojë në ERE shpjegime dhe dokumentacion për sa kërkohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimarrjen e Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti